



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr 331/22

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej znj. Nita Bejta - Kryetar, znj. Kimete Gashi- Anëtare, znj. Vjosa Gradinaj Mexhuani – Anëtare, z. Agon Ramadani – Anëtarë, z. Vedat Poterqoi – Anëtar, duke vendosur sipas ankesës të parashtruara nga grupi i operatorëve ekonomik: “Eing Com” Sh.p.k. & N.P.T. “Daqa”–Podujevë, ka parashtruar ankesë me nr.: 331/22, kundër njoftimit mbi vendimin e AK, (vendimit për dhënie të kontratës), lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Ndërtimi i parqeve dhe lojrave për fëmijë në shkolla fillore ne fshatra ,Kraishtë, Glllogovc, Rubovc, Bujan, Medvec, Topliqan, Krojmir, Baicë, Shalë, Magurë, Puturovc, Smallushë, Llugaxhi, Babush i Muhaxherëve, Banullë, Dobrajë e Madhe, Lipjan-faza II-të -ritenderim” me nr. të prokurimit: 613-22-6097-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK): Kuvendi Komunal Lipjan: me datën 30.09.2022 mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, ankesa e grupit te operatoreve ekonomik:“Eing Com” Sh.p.k. & N.P.T. “Daqa”–Podujevë, ka parashtruar ankesë me nr.: 331/22, kundër njoftimit mbi vendimin e AK, (vendimit për dhënie të kontratës), lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Ndërtimi i parqeve dhe lojrave për fëmijë në shkolla fillore ne fshatra ,Kraishtë, Glllogovc, Rubovc, Bujan, Medvec, Topliqan, Krojmir, Baicë, Shalë, Magurë, Puturovc, Smallushë, Llugaxhi, Babush i Muhaxherëve, Banullë, Dobrajë e Madhe, Lipjan-faza II-të -ritenderim” me nr. të prokurimit: 613-22-6097-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK): Kuvendi Komunal Lipjan.

II. ANULOHET vendimi i Autoriteti Kontraktues Kuvendi Komunal Lipjan lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Ndërtimi i parqeve dhe lojrave për fëmijë në shkolla fillore ne fshatra ,Kraishtë, Glllogovc, Rubovc, Bujan, Medvec, Topliqan, Krojmir, Baicë, Shalë, Magurë, Puturovc, Smallushë, Llugaxhi, Babush i Muhaxherëve, Banullë, Dobrajë e Madhe, Lipjan-faza II-të -ritenderim” me nr. të prokurimit: 613-22-6097-5-2-1 dhe lënda kthehet në Rivlerësim

III. OBLIGOHET Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e grupit të operatorëve ekonomik: “Eing Com” Sh.p.k. & N.P.T. “Daqa” – Podujevë aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesave në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Me datën: 12.08.2022, grupi i operatorëve ekonomik: “Eing Com” Sh.p.k. & N.P.T. “Daqa” – Podujevë dhe ka parashtruar ankesë me nr: 331/22, kundër njoftimit mbi vendimin e AK, (vendimit për dhënie të kontratës), lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Ndërtimi i parqeve dhe lojrave për fëmijë në shkolla flllore në fshatra ,Kraishtë, Gllogovc, Rubovc, Bujan, Medvec, Topliqan, Krojmir, Baicë, Shalë, Magurë, Puturovc, Smallushë, Llugaxhi, Babush i Muhaxherëve, Banullë, Dobrajë e Madhe, Lipjan-faza II-të -ritenderim” me nr. të prokurimit: 613-22-6097-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK): Kuvendi Komunal Lipjan.

GOE ankues “Eing Com” Sh.p.k. & N.P.T. “Daqa” në ankesë pretendon se AK, nuk i ka respektuar dispozitat e neneve 1,7,59,60 dhe 69 të LPP-së si dhe nenet 40 dhe 41 të RRUOPP-së.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, vlera e parashikuar e kontratës: 185,000.00€.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 16.08 2022, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit dhe ekspertin teknik për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palëve ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit dhe eksperti teknik në raportin e dt: 23.08.2022, në raportin e ekspertizës kanë deklaruar:

Përgjigje në Pretendimi nr.1 - Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se Është Kërkuar: Kërkesa nr. Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme (ndërtim i parqeve) në vlerë jo më pak se 250,000.00 € në tre vitet e fundit duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit të kontratës. Në rast të formimit të

grupit (konsorciumit), udhëheqësi i grupit duhet të ketë së paku 60% të shumë së kërkuar Dëshmitë të cilat janë kërkuar sipas dosjes së tenderit: Dëshmia 1. Një liste e kontratave e nënshkruar dhe vulosur nga OE ku do të bëhet përshkrimi me këto informata titullin e kontratës, klientin, datën e fillimit të kontratës, datën e përfundimit të kontratës, vlerën e kontratës, Referencat apo pranimin teknik kopje për kontratat e prezantuara për projekte të ngjashme, Nëse kontrata me reference është me kompani private të dëshmohet me transaksion bankar (dëshmi që është krye pagesa). Referencat apo pranimet teknike duhet të jepen në 3 (tri) vitet e fundit, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontrate)

GOE nuk ka ofruar dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme (ndërtimi i parqeve) në vlerë jo më pak se 250,000.00 € në tre vitet e fundit duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontrate, andaj nuk e ka plotësuar këtë kërkesë sipas nenit 69 të LPP-se – Refuzo tenderin pa kërkuar informacione të mëtejshme.

Refuzimi i kësaj kërkesë nga ana e AK është pa asnjë bazë, sepse vete ka kërkuar kontrata të ngjashme (ndërtim i parqeve), andaj nuk e dimë se cilat kontrata për ndërtim të praqeve nga ana e GOE janë pranuar nga ana e AK kur asnjë kontrate nuk ka ofruar për ndërtim të parqeve sepse e ka cekë brenda ().

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar në analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës së prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, bazuar në bazuar në kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale nën 9.1 & 9.2 të FDT-së.

Operatori ekonomik ka ngarkuar në platformën elektronike e-prokurimi, ka ofruar listen e kontratave të nënshkruar dhe të vulosur, duke bashkangjitur raportet dhe procesverbalet e pranimin lidhur me këto kontrata.

Vlerësimi i tenderëve është përgjegjësi e AK, andaj marr për bazë listen e kontratave të prezantuara dhe kërkesat të FDT-së, shihet qartë se GOE i rekomanduar për kontratë nuk ka prezantuar asnjë kontratë “ndërtimi i parqeve” mirëpo disa kontrata të prezantua në këtë listë nuk mund të thuash se nuk janë të ngjashme (po ashtu nuk janë kërkuar kontrata identike apo të njëjta), po ashtu termi - fjala e-të, ngjashme ka kuptim të gjerë dhe këtë sigurisht e di me se miri AK i cili e ka përcaktuar vet këtë kërkesë. Duke u bazuar në këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK të lartpërmendur dhe analizës së mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë nuk është i qëndrueshëm.

Përgjigje në Pretendimi nr. 2 - Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se Është kërkuar: Kërkesa 4. Katalogë pjesë të katalogut apo prezantime grafike (vizatimet) dhe ose fotografi të produkteve për furnizim, bashkangjitur përshkrimeve teknike detale për artikujt që ofertoni. Dëshmia nr. 2 Dëshmia 4. Dokumentacioni autentik i prodhuesit si katalogë pjesë të katalogut nga prodhuesi me përshkrim teknike detale për artikujt që ofertoni. Në katalog pjesë të katalogut sipas specifikimeve teknike të kërkuara të nënvizohen artikujt për pozicionet e kërkuara.

GOE ka ofruar një fletushkë në të cilën shihen vetëm fotografi të lodrave duke mos ofruar përshkrimin detaj për artikujt që ka ofertuar sipas specifikimit teknik të kërkuar.

Komisioni i vlerësimit ka kërkuar sqarime shtese sa i përket produkteve të lodrave duke bërë shkelje sepse sipas RRUOPP-se ceket shumë qarte që: Është dorëzuar katalogu por mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara/ sipas Nenit 69 të LPP-se – Refuzo tenderin pa kërkuar informacione të mëtejshme.

Për më tepër G.O.E. nuk ka ofruar asnjë dëshmi që ARBËR DEKOR SH.P.K. është kompani e certifikuar dhe e profilizuar sipas normave dhe standardeve për produktet që ka ofruar.

Komisioni i vlerësimit ka bërë shkelje me rastin e pranimin të sqarimeve shtese sepse G.O.E. ka

ofruar produktet tjera ku sipas nenit 59 pika 2 thuhet: 2. Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkojen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues.

Edhe pse AK nuk ka pas drejt të kërkojë sqarime shtesë prap edhe me rastin e pranimin të sqarimeve shtese ka vazhduar me shkelje të njëpasnjëshme.

Ne dosje të tenderit në FDT, pika 4.1. Variantet, nuk autorizohen.

Komisioni i vlerësimit nuk e ka vlerësuar drejtë këtë kërkesë sepse OE ka ofruar dy variante për pajisjet e lodrave dhe pajisjeve të fitnesit e që bien ndesh me kërkesë AK ku ceket qarte si me poshtë që variantet nuk autorizohen dhe OE duhet të dorëzojnë vetëm një variant. (sipas FDT pika 4.1 Variantet autorizohen: Jo ☒)

Këto ndryshime të procedurave me rastin e dorëzimit të "Katalogut" nga GOE vërehen shumë qartë që tjera modele të lodrave ka ofruar me rastin e dorëzimit të DT dhe tjera me rastin e sqarimeve të kërkuara nga ana e komisionit të vlerësimit.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar në analizën e fakteve/dëshmimeve të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës së prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, bazuar në bazuar në kërkesat mbi mundësit teknike dhe/ose profesionale nën 9.1 & 9.2 të FDT-së.

GOE i rekomanduar për dhënie të kontrates ka dorëzuar katalogun për artikuj pa specifikim – përshkrim teknik detal, kurse AK – komisioni i vlerësimit ka kërkuar sqarim shtesë nga GOE të rekomanduar për kontratë me datë 20.07.2022, ndërsa ka pranuar përgjigje me datë 21.07.2022, mirëpo katalogu i dorëzuar nga GOE pas sqarimeve shtesë pëson ndryshime nga ai i dorëzuar me rastin e tenderimit, poashtu në disa artikuj mungon edhe specifikimi teknik – përshkrim teknik detal,

Andaj duke marrë për bazë nën 39.8 të RRUOPP-se, Varësisht nga rasti i paraqitur AK duhet të veproj në përputhje me nën 72 dhe nën 59 të LPP-së, po citoj:

Problemi	Si të veprohet?	Neni i LPP-së
Është dorëzua katalogu por mungon specifikacioni teknik për mallart e ofruara	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtijshëm	Neni 69

Prandaj AK- komisioni i vlerësimit ka shkelur nën 59 par. 2 të LPP-së, ku thote: "Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkojen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues", si dhe nën 7 par. 2 të LPP-se , po citoj: "Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatoreve ekonomik". Duke u bazuar në këto fakte dhe duke pasqyruar kërkesën e AK të lartpërmendur dhe analizës së mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë është i qëndrueshëm.

Përgjigje në Pretendim nr. 3 - Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se Është kërkuar:Kërkesa5. Operatori Ekonomik duhet të posedojë mjete, stabilitet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit a)Kamion kiper me peshë bartëse

min. 10 t,min 2 cope b)Eskavator me 2-3 t min 1.cope c)Lugë ngarkuese 2-3 t min 1.cope d)Cilinderper ngjeshje 2-3 t min1.cope e)Makinë për shtrimin e gomës së ricikluar. min 1.cope i)Makinë për përzierjen e gomës së ricikluar dhe ngjitësit. min1.cope j)Makinë për spërkatje apo hedhjen e gomës (shtresë finale). min1.cope Ne rast te grupit te operatoreve ekonomik liderit i grupit duhet te përmbushë 60% te kërkesës. Të gjitha makineritë të cilat i nënshtrohen LIGJI Nr. 05 L-132 ligji për automjete, duhet të jenë të regjistruara dhe me afat të regjistrimit.

Dëshmia e nr.3Dëshmia 5 Lista e pajisjeve sipas duke i bashkangjitur, Libreza për automjete çka regjistrohen dhe dud-faturë për pajisjet tjera. Ne rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet te ofroj marrëveshjen, marrëveshja duhet te jete ne emër te këtij projekti me kohëzgjatje të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët, duhet te jete e noterizuar dhe nuk mund të jetë më herët se data e publikimit të njoftimit të kontratës..

G.O.E. nuk ka plotësuar këtë kërkesë sepse është kërkuar qe: Ne rast te grupit te operatoreve ekonomik lideri i grupit duhet te përmbushë 60% te kërkesë për makineritë, andaj lideri i grupit “EDONA” Sh.P.K. nuk ka ne pronësi asnjë makineri, por edhe makineritë e ofruara sipas marrëveshjes me “COMPANY MURSELI” SH.P.K. sikurse me poshtë:

b) Eskavator me 2-3 t min 1 cope ka ofruar eskavator marka: Neuson ku pesha është 4900 kg edhe për një eskavator tjetër te cekur sipas listës nuk shihet dudi se çfarë kapaciteti ka.

c) Luge ngarkuese 2-3 t min 1 cope ka ofruar lopata ngarkuese marka: Caterpillar ku pesha është 9300 kg

d) Cilinder për ngjeshje 2-3 t min 1 cope ka ofruar valak te rrugëve marka: Lurken ku pesha është 4500 kg.

GOE NUK kaplotësuar kërkesën për makineritë andaj edhe komisioni i vlerësimit por edhe me rastin e kërkesës për rishqyrtim vetëm se kane vazhduar me shkeljet e njëpasnjëshme.

Refuzimi i kërkesë për rishqyrtim dhe pretendimeve ankimore nga ana e AK shihet qarte qe është pa asnjë baze dhe tendencioz ku nuk ka përfillur asnjë kërkesë te cilën vet i ka publikuar dhe kërkuar, ndërsa tani nuk merr parasysh asnjërin prej tyre.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, bazuar ne bazuar ne kërkesat mbi mundeshit teknike dhe/ose profesionale neni 9.1 & 9.2 të FDT-së. Lideri GOE “Edona” Sh.p.k. i rekomanduar për dhënie te kontrates ka dorëzuar një “draft kontrate dhënie e mjeteve me qira” me OE “Company Murseli” Sh.p.k. te dates: 12.07.2022, e noterizuar me date 12.07.2022 pran noterit SELATIN D. SHAHINI me LRP.Nr. 16189/2022, ku sipas nenit 1te kësaj marrëveshje, thotë: “Qiradhënsi është pronar i mjeteve ndërtimore (tani e tutje i referuar si “mjete”), andaj te njëjtat ia ofron me qira qiramarrësit.

Përshkrimet teknike te mjeteve

1. Kamion – 05-596-GF
2. Kamion – 05-952-EJ
3. Eskavator – Meuson, TYP 5002-RD me nr derik 5357
4. Lugë Ngarkuese – Caterpillar (USA), TYP 128B
5. Cilider – Lurkeny TYP: Dopell

Këto paisje/mjete te prezantuara nga lideri i GOE te dokumentuar sipas DUD (Dokumentit Unik Doganor) janë si ne vijim:

3) Eskavator me 2-3 t min 1 cope ka ofruar eskavator marka: Neuson ku pesha është 4900 kg

4) Luge ngarkuese 2-3 t min 1 cope ka ofruar lopata ngarkuese marka: Caterpillar ku pesha

është 9300 kg

5) Cilinder për ngjeshje 2-3 t min 1 cope ka ofruar valak te rrugëve marka: Lurken ku pesha është 4500 kg.

Kurse edhe për një eskavator tjetër nuk shihet DUD (është i padukeshem) se çfarë kapaciteti/peshe ka, e qe AK ka mundur te veproj sipas nenit 59 par. 2 te LPP-se, dhe nenit 72 te LPP-se, por një gjë të tillë nuk e ka bërë. Duke pas parasysh kërkesën e AK te përcaktuar ne FDT, AK – Komisioni i vlerësimit ka shkelur nenin 59 par. 4 te LPP-së, ku thotë: *“Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”*. Pasi qe paisjet/mjetet 3), 4), dhe 5), nuk plotësojnë kërkesat mbi mundësit teknike dhe/ose profesionale neni 9.1 & 9.2 të FDT-së, kërkesa5/Deshmia5, sepse pesha e tyre është jashtë peshës te peracktuar ne FDT nga AK (janë mbi madhësinë – maksimumin e kërkuar nga AK), si me lart te perzantuar përmes DUD Doganor.

Duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë është i qëndrueshëm.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmime të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, AK – komisioni i vlerësimit, nuk ka respektuar nenin 7, 59, 60, 72 të LPP-së, dhe nenin 39.8 te RRUOPP-së, andaj Është përgjegjësi, dhe në diskrecion të Autoritetit Kontraktues, respektivisht komisionit të vlerësimit – ZPP, që procesi i vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të behet ne harmoni te plote me dispozitat ligjore te LPP-se, ne këtë aktivitet te prokurimit, ne mënyrë qe të respektohen kërkesat e përzgjedhjes, specifikimet teknike Aneksi 1 ne dosje te tenderit si dhe te respektohen kriteret e dhënies.

Eksperti shqyrtues sqaron, se autoritetet kontraktues janë te obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike te përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marr në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së, autoriteti kontraktues duhet te këtë ne konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroj mënyrën më efikas, më transparent dhe më të drejt të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në faktet, sqarimet e lartpërmendura dhe te gjeturat tjera ne këtë raport, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e GOE akues **të aprovohen si të bazuar**, dhe rekomandon të anulohet B58-njoftimit mbi vendimin AK(*vendimit për dhënie të kontratës*) dhe lënda të kthehet në **Ri-vlerësim** duke respektuar në tërësi dispozitat ligjore të LPP-së..

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 23 Gusht 2022 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti kontraktues nuk ka njoftuar OSHP lidhur me qëndrimin e tyre ndaj mendimit te ekspertit shqyrtues.

Operatori ekonomik ankues “Eing Com” Sh.p.k. & N.P.T. “Daqa” me datën 23 Gusht 2022 me anë të parashtrësës ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca e shqyrtimit të lëndës u mbajt me datën 30.09.2022, ku morën pjesë të gjithë anëtarët e panelit shqyrtues, përfaqësuesi i OE-së ankuese, si dhe ekspertit shqyrtues, ndërsa AK është ftuar në mënyrë të rregull të njëjtit nuk kanë kthyer përgjigje as në ekspertizë dhe nuk është paraqitur në seancë.

Përfaqësuesit të OE-së se ankuese "EING COM" z. Podvorica i cili deklaroj: Sa i përket kësaj lënde në pajtohemi plotësisht me mendimin e ekspertit.

Gjatë prezantimit në seancë Eksperti Shqyrtues z. Beqiri i cili deklaroj: qëndroj në tersi pran ekspertizës në bazë të dëshmive dhe prova të ofruar në platformën elektronike.

OE ankues për pretendimin e par pretendon se nuk i plotëson kërkesat lidhur me referencat për të cilin pretendim e kom hudh si të pa qëndrueshme sepse OE ka disa referenca të ngjashme ndërsa lidhur me pretendimin e dytë që ka të bëjë me katalogun e dorëzuar nga OE i rekomanduar për dhenje dhe pas sqarimeve të kërkuara nga AK përsëri nuk e plotëson këtë sepse dorëzon një katalog jo në përputhje me kërkesën e dosjes së tenderit.

Kurse lidhur me pretendimin e tret OE përsëri nuk ka arrit të dorëzojë pajisjet sipas dosjes së tenderit dhe ky pretendim është i qëndrueshëm dhe kom rekomandua që lënda të kthehet në Rivlerësim

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit teknik deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron:

Lidhur me pretendimin e GOE ankuese se GOE e rekomanduar nuk ka përmbushur kërkesën 9.1 dhe 9.2 të FDT-se, me të cilën është kërkuar që OE duhet të ketë të përfunduar me sukses kontrata të ngjashme, PSH duke u mbështetur në raportin e ekspertizës si dhe pas verifikimit të dokumenteve të ofertës konstaton se AK në DT ka kërkuar kontrata të ngjashme e jo të njëjta, dhe GOE e rekomanduar ka ofruar të njëjtat, andaj ky pretendim është i pa bazuar.

Lidhur me pretendim e dytë ankimore të GOE ankuese se GOE e rekomanduar ka dorëzuar katalogun për artikuj pa specifikim dhe për të njëjtin AK ka kërkuar sqarime shtese meqë rast me ofrimin e katalogut nga GOE e rekomanduar mund të bëhet krahasimi mes dy katalogëve dhe lehtësisht vërehet ndryshimi e katalogun e paraqitur në oferte dhe atij të ofruar për sqarime. PSH duke u mbështetur në raportin e ekspertizës si dhe pas verifikimit të dokumentacionit konstaton se AK nuk ka vepruar në përputhje me nenet 72 dhe 59.2 të LPP-së andaj ky pretendim i GOE ankuese është i bazuar.

Lidhur me pretendimin e tretë të GOE ankuese se GOE e rekomanduar nuk ka plotësuar kërkesën nr. 5 si dhe nuk ka ofruar dëshmitë nr. 5 sipas nenit 9.1 dhe 9.2 të FDT-se, PSH mbështetet në tërësi në analizën dhe konstatimet e ekspertit shqyrtues lidhur me këtë pretendim.

Vendimi lidhur me kthimin e tarifës u dha në kuptim të nenit 31 paragrafi 6 i Rregullores së punës së OSHP-se.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Kryetare e PSH-së
Znj. Nita Bejta



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK- KK Lipjan

1x1 GOE "Eing Com" Sh.p.k. & N.P.T. "Daqa"

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.